



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Mars 2022

Ligji i ri

Parlamenti miratoi më 10 mars ligjin për “Zhvillimin dhe mbështetjen e startup-eve”. Një punë e nisur nga një skuadër fantastike e vazhduar nga një skuadër po e tillë. Me të gjithë aktorët e përfshirë ligji i hap rrugën mbështetjes financiare të startup-eve dhe ekosistemit.

Bashkëpunimi

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes znj. Edona Bilali ishte pjesë e takimit “Ekonomia” të organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të adresuar rekomandimet e ardhura nga bizneset dhe dhomat e tregtisë në kuadër të lehtësimit të të bërit biznes, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në vend

Sipërmarrësit

Pas miratimit të ligjit vijojmë me takimet virtuale me lehtësuesit e startup-eve: akademinë, inkubatorët dhe akseleratorët të cilët ndanë me ne programet e parashikuara për këtë vit, sugjerimet dhe kërkesat e tyre.

Diaspora

Pjesë e tryezës së partnerëve organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare me tematikë: “Perspektiva të Reja të Investimit në Atdhe”, vëmendje e veçantë ju kushtua prezantimit të dy projekt propozimeve të Dhomës së Biznesit të Diasporës - Instrumenti Financiar i Diasporës (FIAD) dhe Fluturo me Shqipen.

Të rinjtë

Me të rinj pjesëmarrës në UpShift organizuar në Shkodër ku dëgjoja ide të mirëfillta biznesi mes gjimnazistësh gjeta rastin të jap lajmërimin që përfitues si pjesë e ekosistemit të startup-eve do të jenë edhe shkollat e mesme dhe ato profesionale




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Mars 2022

Konsultime

Sot një tjetër hap drejt mbështetjes së startup-eve dhe ekosistemit. Bashkë me Albanitech organizuam një takim me përfituesit parësor të ligjit: startup-et. Interesi është shumë i lartë dhe sugjerimet e pyetjet me krenari pohoj që janë ezauruar e tejkalar nga qeveria për atë që parashikojmë që në thirrjen e parë.



Investime

Një takim shumë interesant me Z. Sebastiano La Ferla, administrator i kompanisë “Giobert” e vendosur në Durrës. U njoha më nga afër me proceset e punës së kompanisë që operon në sektorin automotiv dhe diskutuam mbi mundësitë e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri.



Çmimet

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Programit të Grave të Biznesit të Vogël në Bashkinë Kamëz. Ky program është pjesë e përpjekjeve për rimëkëmbjen dhe rindërtimin nga tërmeti 2019.



Shkollat

Këtë të dielë një tjetër program po zhvillohet në Shkodër për të rinjtë sipërmarrës. Të rinjtë, nxënës të shkollës së mesme profesionale “Hamdi Bushati”, në fund do të mbështeten edhe me grant për idetë e tyre inovatore dhe jashtë kornizave.

